

NJOFTIM

për

rihapjen e Konkursit për rekrutimin e Regjistruesve për Projektin e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (REKOS 2024)

29.03.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) njofton se ka rihapur Konkursin për pranimin e Regjistruesve aktivë për Projektin e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (ReKos 2024).

Komisionet Komunale të Regjistrimit (KKR) janë ato që e vlerësojnë nëse duhet angazhuar staf në zona të caktuara, kryesisht aty ku ka mungesa dhe nuk ka mundësi zëvendësimi.

Andaj, bazuar në këtë, kërkohet rishpallja e konkursit vetëm për Regjistrues aktivë (ata që do t'i zhvillojnë intervistat).

Dorëzimi i dokumenteve për pozitën e Regjistruesve aktivë do të jetë i hapur vetëm në formën fizike ku dokumentet dorëzohen në Komisionet Komunale të Regjistrimit (KKR) në komunën përkatëse.

Kriteret dhe kushtet e tjera mbeten të njëjta (shih më poshtë) dhe nuk duhet tejkaluar numri i Regjistruesve aktivë të parashikuar për atë komunë, përveç që trajnimet dhe listimi nuk do të paguhet për të gjithë aplikuesit pas datës 29 Mars 2024.

Pagesa bëhet në bazë të realizimit që do të jetë në kontratë.

Komisionet për përzgjedhjen e Regjistruesve bëjnë pranimin, verifikimin e dokumenteve, përzgjedhjen e kandidateve si dhe ruajnë dokumentacionin e duhur.

Të gjithë të interesuarit për këtë pozita duhet të aplikojnë në komunën e tyre.

Konkursi është i hapur deri më nga data 29. 03.2024 deri më 10.05.2024 ora 24:00.

Vlerësimi/poentimi i regjistruësve

1. Kualifikimet arsimore:

Arsimi Fillor: 5 pikë

Arsimi i mesëm: 10 pikë

Fakulteti/Arsimi i Lartë: 20 pikë

Shpjegim: Pikët caktohen në bazë të nivelit të arsimimit pasi mund të ndikojë ndjeshëm në cilësinë e mbledhjes së të dhënave gjatë regjistrimit. Ata me kualifikime të larta arsimore pritet të kenë aftësi më të mira të të kuptuarit dhe komunikimit, duke i bërë ata më efektivë në rolet e tyre. Në rastet specifike kur nuk ka regjistruës në atë zonë (largësi e madhe nga vendi i banimit të regjistruësit deri tek ZR zakonisht mbi 10 km atëherë KKR duhet të vendosë për një regjistruës të zonës ani pse ka një nivel më të vogël të arsimimit.

2. Rëndësia e komunës përkatëse; Komuna përkatëse 20 pikë

Shpjegim: Vlerësimi prej vetëm 20 pikësh pre regjistruësin nga komuna e njëjtë është për arsye që ti jepet përparësi regjistruësit nga vendbanimi përkatës (kjo pre shkak të përvojës me 2011 si deh anketave të rregullta). Në anën tjetër poentimi me 20 pike është i rëndësishëm pasi do të ketë raste kur regjistruësi duhet të jete nga një vendbanim tjetër pro nga komuna e njëjtë. Qëndrimi në të njëjtën komunë ku do të kryhet regjistrimi është me i favorshëm se ardhja nga një komunë tjetër pasi nënkupton një kuptim më të mirë të zonës deh asaj komunë, aspekti logjistikë është me i arsyeshëm. Prandaj, individët që jetojnë në komunën përkatëse marrin 20 pikë.

3. Rëndësia e vendbanimit përkatës; Vendbanimi përkatës 20 pikë.

Meqenëse regjistruësi duhet ta njohë shumë mirë zonën (QR) dhe të jetë i pranueshëm nga pjesa dërmuese e asaj zone (ZR) dhe duke u përfshirë aspektin logjistik është e rekomanduar që regjistruësi të jetë nga vendbanimi i njëjtë. Në rastet kur nuk ka regjistruës nga vendbanimi i përkatës për shkak të kriterëve tjera, niveli i arsimimit mund të jetë me i vogël si i pranueshëm.

Shpjegim: Qëndrimi në të njëjtën vendbanim ku do të kryhet Regjistrimi është i favorshëm pasi nënkupton një kuptim më të mirë të zonës dhe komunitetit lokal, arritje në kohë në atë ZR, aspekti logjistik dhe që të jetë i/e pranueshëm për atë ZR. Prandaj, individët që jetojnë në vendbanimin përkatës marrin 20 pikë.

4. Patentë shoferi: Posedimi i patentë shoferit: 10 pikë.

Shpjegim: Pasja e patentës së shoferit mund të jetë e vlefshme, veçanërisht për regjistruësit e disa zonave që mund të kenë nevojë të udhëtojnë në mënyrë efikase dhe pothuaj e domosdoshme ndërmjet vendeve të ndryshme të regjistrimit (një regjistruës mund të ketë deri në 6 QR).

Meqenëse ne praktikë duhet të ketë distancë më të vogël se nevojës se udhëtimit ky kualifikim shpërblehet me 10 pikë.

5. Përvojë në punë hulumtuese, anketa apo regjistrime: Përvojë në punë hulumtuese, anketa apo regjistrime: 20 pikë

Shpjegim: Përvoja në punën kërkimore ose anketuese është thelbësore pasi tregon njohjen me metodologjitë e mbledhjes së të dhënave, kontrollin dhe sfidat e mundshme. Kjo përvojë njihet me 20 pikë. Rezultati maksimal total që mund të arrijë një individ është 100 pikë, duke reflektuar kualifikimet dhe përshtatshmërinë e tij për rolin e mbikëqyrësit

Këto kriteret vlerësi synojnë të përzgjedhin individë me aftësitë me të përshtatshme, arsimit adekuat, njohuritë dhe përvojën e duhur lokale për të siguruar suksesin dhe saktësinë e regjistrimit të popullsisë. Pikët ndahen në bazë të rëndësisë së secilit kriter, me një pikë totale maksimale prej 100 pikësh si pikë referimi për përzgjedhjen e mbikëqyrësve të kualifikuar të regjistrimit.

Tabela 2. Kriteret për përzgjedhjen e regjistrueseve (kontratës) - 2 muaj

Kriteret vlerësimi për regjistrues/e	Pikët
Shkolla Fillore	5
Shkolla e Mesme	10
Fakulteti/master	20
Shkollimi maximum -me fakultet/master	20
Komuna përkatëse	20
Vendbanimi	30
Patent shoferi	10
Përvoja ne hulumtime (anketa)	20
Piket maksimale	100